



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 91, Datë 02. 04.2026

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “DION ENERGJI” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK,
ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, gërma “a”, 38 pika 1, gërma “a”, 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, 13 dhe 14, pika 9, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 02.04.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 667/7 prot., datë 31.03.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “DION Energji” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “DION Energji” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 667 prot., datë 17.02.2026, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 68, datë 02.03.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 03.03.2026 dhe 04.03.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 12.03.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua dhe në rrjetet sociale si dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- ERE po ashtu ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, nëpërmjet shkresës nr. 667/3 prot., datë 03.03.2026, ku i ka kërkuar të bëjë me dije nëse nga ana e saj ka një qëndrim ndryshe në lidhje me vlefshmërinë e kontratës dhe të drejtën e shoqërisë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 667/6 prot., datë 19.03.2026, MIE është shprehur parimisht dakord për fillimin e procedurave për pajisjen e shoqërisë me licencën e prodhimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën nr. 667/4 prot., datë 03.03.2026 dhe e-mailin me nr. 667/6 prot., datë 26.03.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës dhe i ka kërkuar depozitimin informacionit/dokumentacionit të përditësuar të aplikimit.
- Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 667/5 prot., datë 17.03.2026, dhe e-mailin e datës 26.03.2026, shoqëria ka përditësuar informacionin/dokumentacionin e kërkuar.
- Nga analizimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera:

Shoqëria “DION Energji” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me MIE Kontratën “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 MW dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria “DION ENERGI” sh.p.k.” datë 06.04.2023.
- Ka marrë miratimin e pikës së lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës nr. 6359/3 prot., të “Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a. si dhe ka depozituar “Marrëveshjen e Lidhjes së Re”, nr. 6359/2 prot., datë 28.06.2022.
- Është pajisur me Vendim për VNM Paraprake, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), më datë 13.11.2024, për të zhvilluar projektin për zhvillimin e projektit “Centrali diellor fotovoltaike”, me kapacitet 2 MW.

Kushtet dhe afatet ligjore:

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, gërma “a” të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Shoqëria ka depozituar garancinë 30-vjeçare të performancës për panelet fotovoltaike, ndaj dhe afati i licencës vlerësohet që të jetë për 30 vjet.
- Shoqëria aktualisht disponon një VNM të vlefshme deri më 13.11.2026, dhe duhet të fillojë punimet brenda këtij afati. Por nga ana tjetër, ajo ka parashikuar që të vendosë në operim centralin brenda datës 15.05. 2026, që është brenda afatit të vlefshmërisë së VNM-së përkatëse, si dhe ka argumentuar se punimet tashmë janë në fazën përfundimtare. Në këto rrethana, vlerësohet që të përcaktohet që shoqëria duhet të fillojë operimin brenda datës 15.05.2026.
- Në referencë të përcaktimeve të nenit 10 të kontratës së nënshkruar me MIE-n vlerësohet që shoqërisë t’i lihet kusht që, jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga fillimi i operimit/ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, të depozitojë në ERE

dokumentacionin përkatës për testimin e veprës.

- ERE rezervon të drejtën e rishikimit të këtij vendimi në rast të depozitimit të sa lënë detyrë shoqërisë dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.
- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të respektuar afatet dhe detyrimet e përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “DION Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.
2. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 15.05.2026.
3. Jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga fillimi i operimit/ushtimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës
4. Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushtit të pikave 2 dhe 3 të këtij vendimi dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.
5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “DION Energji” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, OSSH sh.a., dhe ALPEX sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI